

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetar, Fillim Skoro e Xhevdet Abazi, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Syzana Goxhuli, si procesmbajtëse, në lëndën penale të pandehurve M.A.,B.H. dhe E.L., për shkak se kanë kryer veprën penale Grabitja, nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e mbrojtësve të të pandehurve M.A., av.I.M., B.H., av.M.I., E.L., av.M.L., të ushtruara kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.160/2017, të dt.20.11.2017, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me dt.18.01.2018, morri këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve M.A., av.I.M., B.H., av.M.I., E.L., av.M.L. dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.160/2017, të dt.20.11.2017, vërtetohet.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR Prishtinë, PKR.nr.160/2017, të dt.20.11.2017, të pandehurit M.A.,B.H. dhe E.L., që të tre nga Ferizaj, janë shpallur fajtor për veprën penale Grabitja, nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe të pandehurit M.A., ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 500(pesëqind)Euro dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3(tri)vite e 6(gjashtë)muaj, të pandehurit B.H., ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 500(pesëqind)Euro dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3(tri)vite e 6(gjashtë)muaj dhe të pandehurit E.L., ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 500(pesëqind)Euro dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3(tri)vite, në të cilën i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.21.09.2017 gjerë me dt.17.11.2017.

Të pandehurit janë të obliguar që secili dënimin e shqiptuar me gjobë në shumë prej nga 500Euro, ta paguajnë në afat prej 60 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, e nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, nëse dënimin me gjobë nuk e paguajnë në afatin e caktuar dhe e njëjta nuk mund të nxjerrët edhe me detyrim atëherë dënimi me gjobë për secilin të akuzuar, do të zëvendësohet me dënim me burg, në atë mënyrë që për çdo 20Euro, secilit të akuzuar do ti llogaritet nga një ditë burgim.

Të pandehurit secili prej tyre veç e veç, janë obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 Euro, e në emër të kompensimit të viktimave shumën prej 50 Euro, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit Sh.A. dhe B.I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë kanë ushtruar ankesë:

-Mbrojtësi i të pandehurit M.A., av.I.M. , për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovon ankesën, dhe të ndryshon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me vendimin mbi dënimin, ashtu që të akuzuarin M.A., ti shqipton një dënim më të butë.

-Mbrojtësi i të pandehurit B.H., av.M.I. , për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e shkallës së parë ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendim, ose ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar në atë mënyrë që të pandehurit ti shqiptoj trajtim të detyrueshëm psikiatrik në institucionin e kujdesit shëndetësor.

-Mbrojtësi i të pandehurit E.L., av.M.L. , për shkak të vendimit mbi dënimin dhe për caktimin e lartësisë për kompensimin e të dëmtuarve, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe ndaj të pandehurit të shqiptohet një dënim më i butë me burgim, si dhe të detyrohet që të paguajë një gjobë më të ulët, sepse i akuzuari nuk ishte përfutur nga kryerja e veprës penale.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.524/2017, të dt.11.12.2017, duke u sqaruar përkitazi në ankesat e mbrojtësve të të pandehurve, ka propozuar që të refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve M.A., B.H. dhe E.L., lidhur me vendimin mbi dënim-sanksionin penal, meqë nuk qëndrojnë pretendimet e cekura si në këto ankesa kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr 160/2017, të dt.20.11.2017, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në pajtim me nenin 390 par.1 të KPP, caktoi seancën e kolegjit ku morën pjesë pala e dëmtuar B.I., përfaqësuesi i palës së dëmtuar av.B.T., të pandehurit M.A., B.H. dhe E.L., dhe mbrojtësi i të pandehurit E.L., av.M.L., ndërsa në seancë nuk prezantuan Prokurori i Apelit, mbrojtësit e të pandehurve av.M.I. dhe av.I.M., si dhe i dëmtuari Sh.A. edhe pse janë njoftuar në mënyrë të rregullt , dhe seanca është mbajtur në mugës të tyre nga se pjesëmarrja e tyre nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit, konformë dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, pasi që vlerësoj ankesat e mbrojtësve të akuzuarve M.A., B.H. dhe E.L., e duke marrë parasysh edhe mendimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesat e mbrojtësve të të pandehurve M.A., B.H. dhe E.L., refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesat e mbrojtësve të pandehurve M.A., B.H. dhe E.L., e sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 dhe shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e saj.

Mbrojtësi i të pandehurit M.A., av.I.M., në ankesën e tij pretendon se edhe pse gjykata ka aplikuar dispozitat e nenit 75 dhe 76 të KPP dhe të pandehurit ia ka shqiptuar dënimin me gjobë

dhe me burgim në kufijtë e dënimeve të parapara me ligj në kohëzgjatje prej 3(tri)vite e 6(gjashtë)muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 500Euro, rrethanat në rastin konkret justifikojnë se të pandehurit mund ti shqiptohet dënim edhe më i butë, për arsye se gjykata nuk i vlerësuar në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse rrethanat e parapara si në nenin 73 të KPRK.

Mbrojtësi i të pandehurit B.H., av.M.I., në ankesën e tij pretendon se i mbrojturi i tij, është i lindur në vitin 1994 dhe në kohën kur është shpallur fajtor ka pasur më pakë se 23 vite, me status "Madhor i Ri", dhe në opinion njihet si narkoman shumë vjeçar dhe ankesa pretendon se në kuadër të këtyre rrethanave nuk ka mundur ti shqiptohet dënimi me burgim efektiv, por vetëm dënim me kusht, me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues. Ankesa pretendon se i pandehuri B.H., në ndikimin e narkotikëve ka pasur aftësi të zvogëluar mendore dhe varësisht prej kësaj gjykata është dashur t'ia shqiptoj dënimin e merituar siç është paraparë në dispozitën e nenit 19 të KPRK.

Mbrojtësi i të pandehurit E.L., av.M.L., në ankesën e tij pretendon se në këtë çështje penale mungojnë pasojat e dëmshme dhe i mbrojturi i tij, ka shkuar në kryerjen e veprës penale për shkak se ka pasur borxh si konsumues i marihuanës dhe qëllimi i tij që me marrjen e përfitimit të hollave do ta paguajë borxhin. I njëjti ka kërkuar falje dhe këtë e ka shprehur që edhe ndaj të dëmtuarve të kërkoj falje dhe të bëjë kompensimin e dëmit, nëse ai është shkaktuar dhe në kuadër të dispozitave të nenit 75 par.1 nën par.1.3 të KPRK, gjykata t'ia shqiptoj një dënim më të butë, për arsye se nuk detyrohet nga kufizimet e parapara si në nenin 76 të KPRK.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e paraqitura në ankesat e mbrojtësve të pandehurve, janë të pa bazuara, për arsye se gjykata e shkallës së parë, drejt ka vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit mbi dënimin e të cilat janë e të cilat dënime të shqiptuara me gjobë dhe me burgim, janë marrë në kuadër të rregullave të përgjithshme për matjen e dënimin të parapare si në neni 73 të KPRK. Gjykata e shkallës së parë, gjatë marrjes dhe matjes së vendimit mbi dënimin ka pas parasysh rrethanat e parapara, si në nenin 75 të KPRK, lidhur me kufijtë e zbutjes se dënimeve me burgim ndaj të pandehurve, dhe të tre të pandehurve iu ka zbutur dënimet, e duke marr parasysh peshën e veprës penale, sjelljet e të pandehurve, pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, gjë që nënkupton pendimin e thellë të tyre për veprën penale të cilën e kanë kryer në bashkëkryerje, të cilat rrethanat si të vërtetuara i merre edhe Gjykata e Apelit, ndërsa në ankesën e mbrojtësve të pandehurve, nuk është paraqitur asnjë rrethanë posaçërisht lehtësuese që kishte me ndikuar në zbutjen e mëtejme të dënimin për arsyeje se dënimet veç janë zbutur nën minimumin e parapare ligjore dhe dënimet e shqiptuar me gjobë, secilit prej të pandehurve prej nga 500(pesëqind)Euro, dhe dënimin e shqiptuara me burgim të pandehurve M.A. e B.H., me kohëzgjatje prej 3(tri)vite e 6(gjashtë)muaj dhe të pandehurit E.L., në kohëzgjatje prej 3(tri)vite, e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.21.09.2017 gjerë me dt.17.11.2017, janë në përpjesëtim me peshën e veprës penale të pandehurve dhe dënimet e këtilla të shqiptuara do t'iu shpërbej preventives individuale që të pandehurit në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale të këtilla apo të ngjashme si dhe do ti shërbej preventives së përgjithshme që ky dënim edhe te të tjerët të ndikoj që të mos kryejnë vepra penale dhe me dënimet e shqiptuara pritet të arrihet qëllimi i dënimin të paraparë në nenin 41 të KPRK.

Si u cek edhe më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në pajtim me nenin 401 par.1 të KPP.

Procesmbajtëse,

Syzana Goxhuli

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Xhevdet Abazi

Kryetare e Kolegjit,

Tonka Berishaj